LIGJ
Nr. 8/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR THEMELIMIN E QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TË QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.2.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11436, datë 14.2.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR THEMELIMIN E QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vijim të referuara si "Palët".

Me dëshirën për të dhënë kontribut në avancimin e marrëdhënieve dypalëshe-kulturore, në pajtim me nenin 11 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për bashkëpunim në fushën e kulturës, të nënshkruar në Tiranë, më 16 nëntor 2005,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët bien dakord për themelimin e qendrave kulturore dhe informative të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të qendrave kulturore dhe informative të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Republikën e Shqipërisë, në vijim të referuara si "Qendrat kulturore dhe informative".

2. Puna e qendrave kulturore dhe informative zhvillohet në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare, neneve të kësaj Marrëveshje dhe në pajtim me legjislacionin e vendit pritës.

3. Koha e ngritjes së qendrave përcaktohet në bazë të planifikimeve buxhetore të secilës palë.

Neni 2

1. Qendrat kulturore dhe informative do të ngrihen si pjesë e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë të akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe anasjellas.

2. Secila nga qendrat do të drejtohet nga një drejtor, i cili emërohet nga Qeveria e Palës dërguese, ndërsa veprimtaritë e tyre do t'i kryejnë nën udhëheqjen e përgjithshme të kreut të misionit diplomatik – konsullor të Palës dërguese.

3. Drejtorët e secilës prej qendrave kulturore dhe informative, të cilët nuk kanë shtetësinë e vendit pritës, do të jenë mbajtës të pasaportës diplomatike, ndërsa personeli tjetër, që punon në qendrën kulturore dhe informative të secilës Palë, të cilët nuk kanë shtetësinë e vendit pritës, do të jenë mbajtës të dokumenteve zyrtare të udhëtimit. Drejtori dhe personeli i qendrave kulturore të të dyja Palëve do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet në përputhje me Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, të vitit 1961, dhe me legjislacionin në fuqi të Palës pritëse.

Neni 3

1. Palët do të sigurojnë hyrje të lirë në ambientet e qendrave kulturore dhe informative dhe në eventet e organizuara prej tyre.

2. Emrat zyrtarë të qendrave kulturore dhe informative mund të publikohen në tabela, afishe, formularë, si dhe në korrespondencën, materialin informativ dhe komunikues.

3. Secila nga Palët do të zbatojë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar funksionimin normal të qendrave kulturore dhe informative të palës tjetër në përputhje me Marrëveshjen.

Neni 4

1. Qendrat kulturore dhe informative do të jenë në gjendje për të kryer aktivitetet e mëposhtme:

a) të organizojnë në mjediset e tyre një bibliotekë dhe një dhomë leximi;

b) të botojnë ose të importojnë publikime në lidhje me informacionin kulturor dhe shkencor nga vendi i tyre;

c) të shfaqin filma brenda dhe jashtë ambienteve të tyre, me ndërmjetësimin e institucioneve kompetente përkatëse në vendin pritës;

d) të organizojnë në mjediset e tyre ligjërata letrare, shkencore dhe të tjera, të shoqëruara, sipas nevojës, me ilustrime vizuale ose shfaqje muzikore;

e) të organizojnë në mjediset e tyre ekspozita të fotografive, vizatimeve, afisheve, librave, veprave origjinale ose riprodhimeve të artit;

f) të ofrojnë shërbime informative për qytetarët e interesuar të të dyja Palëve, si dhe për qytetarët e vendeve të treta;

g) të publikojnë dhe shpërndajnë buletine informative për ngjarjet dhe eventet e organizuara

nga qendrat kulturore dhe informative, si dhe për punën e qendrave. Informimi përfshin përdorimin e teknologjive bashkëkohore të komunikimit;

h) të mbështesin shkëmbimin e programeve televizive dhe të radios në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit tashmë të përfunduara ndërmjet institucioneve informuese të Palëve.

2. Qendrat kulturore dhe informative do të shpërndajnë falas te publiku informacionin për itinerarin e aktiviteteve, të renditura më lart në pikën 1/e të këtij neni, të cilat do të organizohen në secilën qendër.

Neni 5

Në kryerjen e veprimtarive të përfshira në nenin 4, të kësaj Marrëveshjeje, qendrat kulturore dhe informative do të veprojnë në përputhje me ligjet në fuqi të shtetit në territorin e të cilit janë vendosur.

Neni 6

1. Qendrat kulturore dhe informative janë qendra shtetërore dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohet nga secila Palë Kontraktuese.

2. Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtën të nënshkruajnë në vendin pritës marrëveshje të nevojshme për funksionimin e tyre.

3. Për të mbuluar pjesërisht shpenzimet e tyre, qendrat kulturore dhe informative, gjithashtu, mund të sigurojnë të ardhurat e tyre nga shfaqje ose ngjarje të tjera kulturore.

4. Eksponatët e ekspozitave të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative në mjediset e tyre ose në salla të tjera, si dhe objektet e karakterit artistik, si: libra, CD, kaseta video dhe audio, mund të ofrohen për shitje vetëm me kusht nëse janë paguar detyrimet doganore të mbledhura nga autoritetet doganore dhe të parashikuara në legjislacionin në fuqi të vendit pritës.

Neni 7

1. Palët ofrojnë ndihmë në bazë të reciprocitetit për gjetjen e një mjedisi, ndërtese ose trualli të përshtatshëm për veprimtarinë e qendrave kulturore dhe informative. Kushtet për marrjen me qira ose blerjen e një mjedisi, ndërtese apo trualli të tillë përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palës pritëse.

2. Qendrat kulturore dhe informative mund të pajisen me mjete të përshtatshme, audio-vizuale, informative, telekomunikuese dhe mjete të tjera të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të tyre në përputhje me këtë Marrëveshje.

3. Palët, në bazë të reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palëve, do të çlirojnë qendrat kulturore dhe informative nga pagesa e detyrimeve doganore, taksave për kushtet e magazinës dhe kushtet e një natyre të ngjashme, në përputhje dhe në masën që përcaktohet në dispozitat e Konventës së Vjenës për mallrat e importuara që nuk janë për shitje, të numërtuara si më poshtë:

a) katalogët, afishet, njoftimet, programet, librat, imazhet dhe materialet audio-vizuale, të nevojshme për funksionimin normal të qendrave kulturore dhe informative;

b) mallrat për import të përkohshëm: pajisjet teknike, mobiliet dhe materiali, duke përfshirë mjetet e trafikut të nevojshme për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative;

c) filmat, të projektuar në ambientet e qendrave kulturore dhe informative ose jashtë tyre, në kuadër të eventeve të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative;

d) çdo lloj tjetër materiali me natyrë kulturore dhe informuese, i nevojshëm për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative.

4. Bëjnë përjashtim nga parashikimi i pikës 3, taksat për formalitetet doganore të kryera jashtë

institucioneve të parashikuara për këtë qëllim ose jashtë orarit të punës të autoriteteve doganore.

Neni 8

Tatimi mbi të ardhurat e qendrave kulturore dhe informative është në përputhje me legjislacionin tatimor të vendit pritës, si dhe me marrëveshjet ekzistuese dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 9

1. Palët njoftojnë njëra-tjetrën për plotësimin e përbërjes së personelit në qendrat kulturore dhe informative, si dhe emërimin dhe shkarkimin e personelit të tyre.
2. Personat që përbëjnë personelin e qendrave kulturore dhe informative dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë shtetas të vendit dërgues dhe që nuk kanë qëndrim të përhershëm në shtetin pritës, i nënshtrohen rregulloreve të legjislacionit të punës dhe sigurimeve shoqërore të shtetit dërgues.
3. Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtë të punësojnë shtetas nga vendi pritës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës të vendit pritës.

Neni 10

1. Secila nga Palët, në bazë të reciprocitetit, do t'u japë personave nga personeli i qendrave kulturore dhe informative të palës tjetër, si dhe bashkëshortëve dhe fëmijët që jetojnë me ta, të gjitha lehtësirat, në përputhje me legjislacionin aktual për lëshimin në kohë të vizave dhe lejeve të qëndrimit në vendin pritës.
2. Lehtësira të ngjashme u jepen, gjithashtu, pjesëmarrësve në eventet kulturore brenda programeve të punës së qendrave kulturore dhe informative.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve midis Palëve.

Neni 12

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin njoftohet për kryerjen e procedurave të brendshme juridike, të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes në fjalë.
2. Marrëveshja është lidhur për një. periudhë prej pesë vjetësh. Vlefshmëria e saj zgjat automatikisht për çdo periudhë pasuese prej pesë vjetësh, derisa njëra prej Palëve të mos e njoftojë me shkrim Palën tjetër, të paktën gjashtë muaj para mbarimit të afatit përkatës, me qëllim për të ndërprerë vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje.
3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet me pëlqim të ndërsjellë të Palëve. Ndryshimet dhe plotësimet do të hyjnë në fuqi në pajtim me përcaktimin e pikës 1 të këtij neni.

Bërë në Uashington, më 3 prill 2019, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, maqedonase dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT